



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.01/2017
Prishtinë, më 10.10.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Qëndron Kastrati dhe Mimoza Kusari – Lila, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sylejman Blaku – Kosova Sot, Etleva Malushaj – LVV, Albert Krasniqi – KDI dhe Amir Kozmaqi – INDEP.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Konstituimi i komisionit.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

1. Konstituimi i komisionit

Kryetarja, përshëndeti anëtarët e komisionit dhe ua uroi mandatin e deputetit. Po ashtu, përshëndeti mediat, stafin mbështetës të komisionit dhe të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e parë konstituive të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Kryetarja theksoi se ka kuorum, kjo është mbledhja e parë e kësaj legjislature dhe e shpalli të konstituuar Komisionin funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Theksoi se kam pas fatin të jem në këtë Komision edhe ne legjislaturat e kaluara, tani për mua është legjislatura e pestë që jam deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe pjesë e këtij komisioni. Ky komision ka qenë një ndër komisionet më të suksesshme, në kuadër të mekanizmave të Kuvendit. Në këtë komision, vazhdimisht ka ekzistuar një frymë e mirë bashkëpunimi në mes të kolegëve deputetë, të cilët kanë përfaqësuar grupet parlamentare të tyre. Po ashtu, ceku se komisioni përfshin një gamë të gjerë të fushave të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe potencoi se këtij komisioni i përgjigjen katër ministri dhe tetë agjenci të pavarura. Ajo garantoj angazhim maksimal që, si kryetare, të ruajë frymën e unitetit, bashkëpunimit, harmonizimit dhe të konsultimit të gjerë, për interes të përgjithshëm shtetëror. Në vazhdim, paraqiti fushëveprimin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal. Më pas, paraqiti edhe përbërjen e këtij komisioni parlamentar. Pastaj hapi debatin për deputetët që dëshirojnë të marrin fjalën.

Adem Hoxha, përshëndeti të gjithë të pranishmit, duke potencuar se është nga Partia e Goranëve, përfaqëson Grupin Parlamentar Lista Serbe dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim konstruktiv në punën e komisionit.

Dardan Molliqaj, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe pyeti për orarin e mbledhjeve, se kur do të caktohen mbledhjet, për shkak se është anëtar në dy komisione.

Gani Dreshaj, theksoi se është një komision me mjaft rëndësi dhe sugjeroi që komisioni të përcaktohet sot për ndonjë pikë të rendit të ditës, për mbledhjen e radhës, që të vijmë më të përgatitur. Ai ngriti disa çështje që duhet trajtuar, si problemin e naftës pa cilësi dhe vajrave jociësore të makinave, numrin e madh të makinave me tabela të regjistrimit nga Mali i Zi dhe Shqipëria që qarkullojnë në Kosovë, për shkak të doganës së lartë, ku këto gjëra do të duhej të zgjidhen sa më shpejt në komision.

Kryetarja sqaroi se sapo të miratohet Programi legjislativ, ne do ta bëjmë planin e punës së komisionit dhe në plan do të parashihen temat që do t'i trajtojmë. I njoftoi anëtarët e komisionit se Kosova është anëtare e Komunitetit të Energjisë, dhe duke qenë anëtare, ne jemi edhe anëtar të Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, ku secili shtet ka nga dy anëtarë të parlamenteve, anëtarë të përhershëm. Pra, ne kemi një ftesë, që deri më 16 tetor, duhet t'i përcjellim emrat e dy anëtarëve, njëri nga pozita dhe tjetri nga opozita, si dhe emrat e dy anëtarëve alternativë. I njoftoi deputetët se përfaqësues të Komunitetit të Energjisë do të vijnë të takohen

me ne, më 13 dhjetor dhe do të na njoftojnë se deri ku kemi arritur me përmbushjen e obligimeve ndaj Komunitetit të Energjisë.

Hykmete Bajrami, theksoi se Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe deri në vitin 2022, Kosova e ka obligim që të ketë rezerva të naftës 30% të shpenzimit të naftës, pra që shpenzohet brenda vitit. Përveç shqetësimit për naftën, është edhe shqetësimi për sigurinë e ushqimit, sepse ushqim konsumojnë të gjithë dhe ushqimi në Kosovë është tepër i pasigurt. Kjo nuk bie në fushën e komisionit tonë, por sidoqoftë ka edhe probleme tjera. Ajo potencoi se sa ishte ministre, në Kuvend e ka sjellë ligjin e naftës, ashtu siç e ka sjellë edhe zonja Kusari dhe ligji e ka pasur pikërisht për qëllim që t'i obligojë kompanitë, që të kenë rezervuarin për të krijuar rezerva të naftës, për të arritur 30% të shpenzimeve vjetore, deri në vitin 2022. Po ashtu, qëllimi ka qenë që nafta të kontrollohet, pasi të zbrazet në rezervuarë në sasi të mëdha e jo çdo maune, sepse ka një kosto të lartë të analizave. Këtë kusht nga Komuniteti i Energjisë, për rezervat, nuk jemi afër për ta plotësuar dhe duhet të punojmë për ta plotësuar, sepse do të diskutohet me Komunitetin e Energjisë.

Memli Krasniqi, përshëndeti të gjithë dhe u uroi punë të mbarë, duke theksuar se nafta është një temë e rëndësishme për të diskutuar dhe ndoshta duhet të marrim hapa për adaptim të legjislacionit, që t'i sjellë dobi qytetarëve.

Bilall Sherifi, përshëndeti të pranishmit dhe lidhur me Plenumin Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, theksoi se për shkak të angazhimeve të shumta edhe si shef i grupit parlamentar, të jetë dikush tjetër anëtar alternativ në këtë Plenum dhe e propozoi z. Gani Dreshaj.

Pas diskutimeve, komisioni, nxori këtë:

Përfundim

1. Në Plenumin Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, caktohen: Sala Berisha-Shala dhe Dardan Sejdiu, anëtarë të përhershëm, ndërsa Hykmete Bajrami dhe Gani Dreshaj, anëtarë zëvendësues;
2. Mbledhjet e komisionit, në parim, do të mbahen të martave, prej orës njëmbëdhjetë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Sala Berisha – Shala
